

I. Struktura Organizative e Planit Hetimor

Hapi 1: Përcaktimi i Qëllimeve dhe Objektivave të Hetimit

Hapi 2: Përcaktimi i Kufijve dhe Juridiksionit të Hetimit

Hapi 3: Strukturimi i Ekipit Hetimor

Hapi 4: Planifikimi i Procesit të Mbledhjes së provave

Hapi 5: Seanca të Dëgjimit dhe Analizë

Hapi 6: Raportimi dhe Rekomandimet

Hapi 7: Ndërmarrja e Veprimeve të Mëtejshme

Hapi 1: Përcaktimi i Qëllimeve dhe Objektivave të Hetimit

Qëllimet:

1. Evidentimi i çështjeve që parashtrajnë domosdoshmërinë e kryerjes së ndryshimeve/përmirësimeve ligjore a nënligjore.
2. Evidentimi i çështjeve me karakter administrativ që parashtrajnë domosdoshmërinë e kryerjes së veprimeve të caktuara nga subjekte të caktuara të ekzekutivit apo institucione të pavarura.
3. Evidentimi i çështjeve me karakter disiplinor dhe/ose penal që parashtrajnë domosdoshmërinë e përcjelljes së tyre pranë organit kompetent administrativ dhe/ose organit të prokurorisë për veprime të mëtejshme hetimore apo për sqarimin e çështjeve aktuale apo të mëparshme objekt hetimi.

Objektivat:

1. **Konteksti politik që i parapriu dhe shoqëroi dy koncesionet objekt hetimi**
Evidentimi i kontekstit të vullnetit/iniciativës politike qeverisëse në drejtim të kujdesit shëndetësor, përgjatë periudhës 2013 – 2017, vullnet/iniciativë kjo e cila evidentohet por nuk kufizohet në: (i) në programin politik të miratuar, (ii) iniciativat ligjore dhe nënligjore, (iii) deklaratimet publike, etj.
2. **Konteksti i realitetit të gjendjes së shërbimeve shëndetësore që i parapriu dy koncesioneve objekt hetimi.**
Evidentimi i gjendjes së shërbimeve të kirurgjisë në spitalet e vendit, deri para vitit 2014, duke u përqendruar ndër të tjera edhe në kujdesin parandalues të sëmundjeve jo ngjitëse, nevojat e popullsisë së shëndetshme, aksesin në kujdesin shëndetësor, kapacitetet e institucioneve shëndetësore, të dhënat statistikore të tyre dhe efikasitetin e shërbimeve ekzistuese të ofruara.
Evidentimi i arsyeve se përse nuk u vunë në punë investimet e bëra përgjatë periudhës 2009 – 2013 për nevoja të sistemit shëndetësor publik.
3. **Konteksti makroekonomik që parapriu dhe shoqëroi dy koncesionet objekt hetimi.**
Evidentimi dhe vlerësimi i mundësive reale buxhetore, përgjatë periudhës 2014 – 2016, për të rritur shpenzimet buxhetore në sektorët socialë dhe për të rritur huamarrjen me qëllim bërjen e investimeve të nevojshme.
4. **Konteksti i kuadrit rregullator që parapriu dhe shoqëroi dy koncesionet objekt hetimi.**
Evidentimi i kuadrit rregullator ligjor dhe nënligjor të aplikueshëm që parapriu dhe shoqëroi më pas dy koncesionet objekt hetimi, duke evidentuar në të boshllëqet e ndryshme ligjore a nënligjore, elementë të mundshëm paqartësie apo mospërputhje.
Evidentimi i kuadrit rregullator të BE që mund të shërbente si udhërfim dhe

përputhshmëria ndër vite e kuadrit përkatës rregullator shqiptar me atë të BE, duke evidentuar dhe mangësitë aktuale dhe nevojat imediate për përmirësim.

5. Konteksti i eksperiencës ndërkombëtare në fushën që mbulojnë dy koncesionet objekt hetimi.

Evidentimi i eksperiencës ndërkombëtare në fushën e koncesioneve/ppp-ve në sektorin e shëndetësisë dhe më konkretisht në fushën që mbulojnë dy koncesionet objekt hetimi.

6. Konteksti i objektivitetit/aktualitetit të studimit të fizibilitetit përgjatë periudhës së zbatimit të dy koncesioneve objekt hetimi.

Evidentimi nëpërmjet akteksptimeve i objektivitetit/aktualitetit të analizës/konkluzioneve të studimit të fizibilitetit përgjatë periudhës së zbatimit të dy koncesioneve objekt hetimi, duke analizuar metodologjinë e studimit, të dhënat e përdorura, ndarjen e risqeve ndërjet partnerëve dhe koston në raport me përfitimin e marrë.

7. Konteksti i ecurisë së deritanishme të zbatimit të kontratave koncesionare.

Evidentimi nëpërmjet akteksptimeve i përfitimeve dhe problematikave që kanë shoqëruar zbatimin e deritanishëm të kontratës koncesionare, duke u përqëndruar por pa u kufizuar në standardet ndërkombëtare të arritura, materializimin faktik të risqeve të parashikuara në kontratë, vlerësimin e arritjes faktike të treguesve financiarë IRR dhe NPV dhe krahasimin e tyre me parashikimet e bëra në studimin e fizibilitetit, vlerësimin e performancës së kontratave koncesionare objekt hetimi, vlerësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar, impaktin në shëndetin e popullsisë, impaktin në financat publike, impaktin në buxhetet e familjeve, impaktin në ekonominë e vendit, impaktin social (punësimet) dhe vlerësimin e përputhshmërisë së kontratës.

Hapi 2: Përcaktimi i Kufijve dhe Juridiksionit të Hetimit

Hetimi do të shtrihet përgjatë periudhës kohore 2009 – 2014 që konsiderohet si periudha para fillimit të procedurës koncesionare, përgjatë periudhës kohore 2014 – 2015 që do të konsiderohet si periudha e zhvillimit dhe finalizimit të procedurës së dhënies me koncesion, dhe përgjatë periudhës kohore 2015 – 2023 që do të konsiderohet si periudha e zbatimit të kontratës koncesionare.

Hetimi do të shtrihet në veprimtarinë dhe dokumentacionin e subjekteve si më poshtë:

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- FSDKSH
- Ministria e Financave
- Spitalet ku zbatohet kontrata koncesionare
- Kuvendi i Shqipërisë (në lidhje ndryshimet ligjore ndër vite, miratimin e programeve të qeverisë, etj)
- APP (në lidhje me miratimin e akteve nënligjore)
- KLSH (raportet relevante të auditimit)
- Avokati i Shtetit (dhënie mendimi mbi draft kontratat dhe amendimet e tyre)

Kuadri rregullator objekt hetimi:

- Kushtetuta, ligji për kujdesin shëndetësor, ligji për pajisjet mjekësore, ligji për dhënien me koncesion/ppp, ligji për prokurimet, ligji për menaxhimin financiar, ligji për funksionimin e Këshillit të Ministrave dhe administratës publike, si dhe ndryshimet e tyre ndër vite
- Aktet nënligjore të dala në zbatim të tyre

- Udhëzime, manuale
- Direktivat e BE-së

Akte të ndryshme objekt hetimi:

- Projektbuxhetet e Ministrisë së Shëndetësisë, FSDKSH dhe QSUT për vitet 2012, 2013
- Raportet e ISSH për gjendjen e sallave operatore dhe infeksioneve spitalore
- Procesverbale të komisionit të dhënies me koncesion
- Studimi i fizibilitetit dhe aktet që e shoqërojnë atë
- Ofertat ekonomike të paraqitura nga ofertuesit
- Kontrata koncesionare
- Raporte të Ministrisë së Financave në lidhje me ecurinë e materializimit të risqeve ndër vite
- Statistika të ndryshme të Institutit të Statistikave
- Botime/raporte të ndryshme të OBSH, Bankës Botërore, BE
- Botime/raporte të ndryshme të eksperiencave më të mira të huaja ndërkombëtare
- Kontrata të ngjashme koncesionare në vende të tjera të huaja#
- Raportet e auditimit të KLSH
- Raporte monitorimi të FSDKSH
- Vendime të KPP në lidhje me procedurat koncesionare
- Raporte të hetimeve të kryera nga APP
- Mendime/sugjerime të Avokaturës së Shtetit në lidhje me draft kontratat koncesionare dhe amendimet e tyre
- Dokumentacioni i hartuar dhe dorëzuar nga koncesionari në funksion të raportimit për zbatimin e kontratës koncesionare
- Dokumentacioni monitorues i zbatimit të kontratës koncesionare i FSDKSH, MSH, spiataleve.
- Dokumentacioni i vlerësimeve/certifikimeve të ndryshme ndërkombëtare të kompanisë koncesionare
- Dokumentacioni në arkivën e Kuvendit në lidhje em ndryshimet e ndryshme ligjore që i janë bërë ndër vite ligjit për koncesionet dhe ligjit për prokurimet (sëbashku me procesverbalet e komisioneve)

Hapi 3: Strukturimi i Ekipit Hetimor

Përbërja dhe Detyrat:

Kryesuesi i Hetimit:

Kryetari/Nënkryetari i komisionit me detyrë kryesore kordinimin e gjithë veprimtarisë së anëtarëve të komisionit dhe ekspertëve ligjor në raport me këtë plan hetimi.

Anëtarët e Ekipit:

Përfshijnë anëtarët e komisionit ekspertë në prokurim publik, shëndetësi publike, financë dhe ligj.

Detyrat:

Çdo anëtar mund të zgjedh një fushë specifike hetimi bazuar në ekspertizën e tij.

Hapi 4: Planifikimi i Procesit të Mbledhjes së provave

Metodat dhe Burimet:

Intervistat:

Planifikimi i intervistave (të mbyllura) me:

- zyrtarë dhe/apo ish zyrtarë të Qeverisë, MSH, FSDKSH, QSUT, spitaleve të ndryshme, etj.
- ekspertë të pavarur,
- përfaqësues të kompanive koncesionare, dhe
- palë të tjera të interesuara.

Secili prej anëtarëve të komisionit ose/dhe në grupe anëtarësh, mund të realizojë intervista të mbyllura me aktorët e lartpërmendur, për të marrë informacion mbi objektin e hetimit dhe përgatitjen e tij për hetimin parlamentar.

Intervistat janë instrument orientimi për hetimin dhe i identifikimit të provës.

Secili prej anëtarëve relatton intervistat e bëra në komision dhe shpjegon provat e identifikuarra dhe që kërkon të merret.

Dokumentacioni:

Mbledhja e dokumenteve të rëndësishme:

- Projektbuxhetet e Ministrisë së Shëndetësisë, FSDKSH dhe QSUT për vitet 2012, 2013
- Raportet e ISSH për gjendjen e sallave operatore dhe infeksioneve spitalore
- Procesverbale të komisionit të dhënies me koncesion
- Studimi i fizibilitetit dhe aktet që e shoqërojnë atë
- Ofertat ekonomike të paraqitura nga ofertuesit
- Kontrata koncesionare
- Raporte të Ministrisë së Financave në lidhje me ecurinë e materializimit të risqeve ndër vite
- Statistika të ndryshme të Institutit të Statistikave
- Botime/raporte të ndryshme të OBSH, Bankës Botërore, BE
- Botime/raporte të ndryshme të eksperiencave më të mira të huaja ndërkombëtare
- Kontrata të ngjashme koncesionare në vende të tjera të huaja
- Raportet e auditimit të KLSH
- Raporte monitorimi të FSDKSH
- Vendime të KPP në lidhje me procedurat koncesionare
- Raporte të hetimeve të kryera nga APP
- Mendime/sugjerime të Avokaturës së Shtetit në lidhje me draft kontratat koncesionare dhe amendimet e tyre
- Dokumentacioni i hartuar dhe dorëzuar nga koncesionari në funksion të raportimit për zbatimin e kontratës koncesionare
- Dokumentacioni monitorues i zbatimit të kontratës koncesionare i FSDKSH, MSH, spitaleve.
- Dokumentacioni i vlerësimeve/certifikimeve të ndryshme ndërkombëtare të kompanisë koncesionare
- Dokumentacioni në arkivën e Kuvendit në lidhje me ndryshimet e ndryshme ligjore që i janë bërë ndër vite ligjit për koncesionet dhe ligjit për prokurimet (sëbashku me procesverbalet e komisioneve).

Ekspertet:

- Caktimi i ekspertëve financiar për vlerësimin kosto-përfitim të kontratave objekt hetimi parlamentar si dhe caktimi i detyrave për ekspertët.

Vizitat në Terren:

Organizimi i vizitave në institucionet ku zbatohen kontratat për të vëzhguar zbatimin dhe të intervistuar stafin dhe pacientët.

Hapi 5: Seanca të Dëgjimit dhe Analizë

Planifikimi dhe Zbatimi:

Seanca Publike dhe të Mbyllura:

Caktimi i datave për seancat e dëgjimit, përcaktimi i formatit (publik ose i mbyllur), dhe përgatitja e listës së dëshmitarëve.

- Seanca dëgjimi me të gjithë Ministrat e Shëndetësisë që nga 1 dhjetor 2006 e deri më sot.
- Seanca dëgjimi me të gjithë ish drejtuesit e QSUT që nga 1 tetor 2009 (kontrata është lidhur në tetor 2009) për të evidentuar se çfarë përpjekjesh janë bërë për ti vënë në punë pajisjet e centralit të sterilizimit dhe çfarë pengesash kanë hasur.
- Seanca dëgjimi me profesorë apo ish profesorë (në pension) të QSUT.
Mentor Petrela
Etmond Celiku
Arben Beqiri
Nikollaq Kacani
Mustafa Xhani
Arvin Dibra
- Seanca dëgjimi me drejtues apo ish drejtues spitalesh (mjeke kirurge, obsteter gjinekolog)
Arben Zeneli ish drejtues i Trauma
Bruna Mersini drejtore e SR Vlore
Senad Halluni drejtor i SR Shkoder
Alban Ylli (Check – up)
Artan Goda (Check – up)
Mihal Tase (Check – up)
Agron Ylli (Check – up)
Myftar Barbullushi (Check – up)
- Seanca dëgjimi me mjekë të parësorit, drejtues të QSHve Tirane dhe jashte Tirane
- Seanca dëgjimi me drejtues të shoqatës së mjekëve të familjes
- Seanca dëgjimi me punonjës/drejtues të ATRAKO për ndjekjen e koncesioneve
- Seanca dëgjimi me punonjës/drejtues të APP për kuadrin rregullator plotësues të koncesioneve
- Seanca dëgjimi me MF për procesin e miratimit të studimit të fizibilitetit dhe monitorimin e kontratave koncesionare.
 - o Irena Beqiri ish zvMinistre e Financave.
 - o Geraldina Prodani ish Sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Financave
 - o Arjan Dyrmishi ish Drejtore e Politikave Fiskale.
 - o Gentian Opre Drejtor i Buxhetit.
- Seanca dëgjimi me MSH për procesin e zbatimit të kontratës koncesionare
- Seanca dëgjimi me FSDKSH për procesin e zbatimit të kontratës koncesionare.

- Albana Adhami ish Drejtore e FSDKSH
- Spartak Zekja Drejtor i FSDKSH
- Seanca dëgjimi me Audituesit e KLSH-së për procesin e auditimit të koncesioneve objekt hetimi.
 - Nerenxa Llapashtica audituese e KLSH
 - Alketa Kalleshi audituese e KLSH
 - Blerim Shkurti auditues i KLSH
 - Erion Gjini auditues i KLSH
 - Anxhela Nesturi audituese e KLSH
 - Eduart Stefani auditues i KLSH
 - Klarenc Xhaferraj auditues i KLSH
 - Irma Idrizaj auditues i KLSH
 - Fatmir Zilja auditues i KLSH
 - Melina Kabo audituese e KLSH
 - Semiram Jakupi auditues i KLSH
- Seanca dëgjimi me Administratorët e kompanive koncesionare.
 - Admir Dacin administrator i Sani Servis
 - Altin Fani administrator i PPP Life Logistic
 - Artan Kalleshi drejtor teknik në Sani Servis
- Seancë dëgjimi me z. Gjergj Koja përgjegjes i sektorit të Infeksioneve Spitalore në ISHP në vitet 2012 – 2013
- Seancë dëgjimi me z. Gazmend Bejtja dhe z. Erol Çomo mjekte anetare të grupit të punës që ka hartuar Check Up.

Analiza e të dhënave të mbledhura:

Përpunimi i të dhënave të mbledhura për të identifikuar tendencat, problemet dhe shkeljet e mundshme.

Hapi 6: Raportimi dhe Rekomandimet

Draftimi dhe Publikimi:

Struktura e Raportit:

Një përmbledhje ekzekutive, analizë të thelluar për çdo objektiv, gjetjet kryesore, dhe rekomandimet për përmirësime dhe ndërhyrje të mundshme.

Diskutimi në Parlament:

Prezantimi i raportit për diskutim dhe ndjekje të mëtejshme.

Hapi 7: Ndërmarrja e Veprimeve të Mëtejshme

Zbatimi dhe Monitorimi:

Plani i Veprimit:

Hartimi i një plani veprimi për zbatimin e rekomandimeve, duke përfshirë afatet dhe përgjegjësit.

Monitorimi:

Caktimi i një mekanizmi për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve dhe vlerësimin e ndikimit të tyre në sistemin shëndetësor.

II. Kalendarizimi i planit hetimor, duke respektuar afatin 4 mujor të hetimit.**III. Planifikimi i buxhetit financiar për gjithë shpenzimet e planit të hetimit.**

Shpenzimet dhe trajtimi financiar i anëtarëve të Komisionit Hetimor, apo shpenzimet për thirrjen e ekspertëve apo konsulenca të tjera të nevojshme mbulohen nga Kuvendi sipas vendimeve të brendshme të tij.

Një specialist finance i administratës së kuvendit ndjek nga afër punën e komisionit dhe përgatit aktet për mbulimin e shpenzimeve dhe trajtimit financiar të anëtarëve të komisionit dhe ekspertëve të caktuar nga komisioni.